

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                                         |
|---------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Malaj: Po analizojmë marzhet e çmimeve - MF kërkon të identifikojë hapësirat për ndërhyrje fiskale në lehtësim të konsumatorëve                                                                                                                         |
| ADRESA  | <a href="https://www.gazetatema.net/ekonomia/malaj-po-analizojme-marzhet-e-cmimeve-mf-kerkon-te-i-dentifikoje-hapesir-i586903">https://www.gazetatema.net/ekonomia/malaj-po-analizojme-marzhet-e-cmimeve-mf-kerkon-te-i-dentifikoje-hapesir-i586903</a> |
| BURIMI  | gazetatema.net                                                                                                                                                                                                                                          |
| GJENDJA | redirected                                                                                                                                                                                                                                              |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 18 shtator 2026, 14:24:26 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 14:50:00 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 45cbb7a254a3f30e100bd82aaf338f0549e4c9ae381d28c4a7e32cd65a3badd7 |
| TEKSTI     | bf3534b024990592429058fbb3ce0e16223eba4d0093f8b43afa3bfc9a29d593 |
| PAMJA      | 9c2ea4cf8bf8a3b1fdfcddb55a52437d382b86c08ca33eb973e81a850413e3f3 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | ac526cf427672c1dad3aba87f701cee22b74dbc4ce2a939cab1e24603790acd9                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 565145c81569d96b39079f1db9ed9e378c0d0ec132a26687d139f465bf7be21b                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ac526cf427672c1dad3aba87f701cee22b74dbc4ce2a939cab1e24603790acd9>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



ie Lady Gaga e solli ne jete femijen e saj nepermjet nje nene zevenesuese" Do thoni ne djall ato qe ntuam". Rama paralajmeron supermarketet. kerkon transparence per cm fundit

## Malaj: Po analizojmë marzhet e çmimeve - MF kërkon të identifikojë hapësirat për ndërhyrje fiskale në lehtësim të konsumatorëve



18 Shtator 2026, 16:50Ekonomia TEMA



Ministria e Financave po analizon marzhet e fitimit në të gjithë zinxhirin e formimit të çmimeve, nga prodhuesi ose importuesi deri te konsumatori final. Lajmi u bë i ditur nga ministri Petrit Malaj gjatë takimit me përfaqësues të supermarketeve dhe furnitorëve, në kuadër të nismës "Pasqyra e Çmimeve".

Malaj tha se analiza synon të identifikojë sektorët dhe hallkat e zinxhirit ku krijohen marzhet, si dhe të vlerësojë nëse ato i përgjigjen kushteve të tregut apo janë më të larta se sa justifikojnë kostot.

Sipas ministrit, të dhënat do t'i shërbejnë qeverisë për të kuptuar më mirë strukturën e çmimeve dhe për të identifikuar hapësirat ku mund të ndërhyhet përmes politikave fiskale, me synim uljen e barrës për konsumatorët.

Një tjetër element i ngritur nga Malaj ishte forcimi i lekut ndaj euros. Sipas tij, zhvlerësimi i euros ka ndikuar në të ardhurat buxhetore nga importet. Për shtatëmuorin e parë të vitit, ministri tha se kjo ka sjellë një mungesë në buxhet prej rreth 50 milionë eurosh.

Sipas tij, ky efekt duhej të reflektonte në paktën pjesërisht në çmimet e produkteve të importuara, ndërsa analizat e Ministrisë së Ekonomisë tregojnë se çmimet mesatare për produktet bazë dhe të shportës mbeten të larta.

Malaj u bëri thirrje supermarketeve dhe furnitorëve të bashkëpunojnë vullnetarisht me këtë proces, duke paralajmëruar se në të kundërt qeveria do të vijojë analizën pranë subjekteve për të mbledhur të dhënat e nevojshme.

"Ne do ta bëjmë këtë analizë, ne do t'i vlerësojmë të gjitha marzhet", deklaroi ministri, duke theksuar se rezultati do të përdoret për orientimin e politikave fiskale që synojnë lehtësimin e konsumatorëve nga çmimet e larta.



Lini një Përgjigje

Koment \*

Emër \*

POSTOJE KOMENTIN

["Kemi çmimet më të larta në rajon", Ibrahimaj: Prishim ulje të kostove të produkteve pas forcimit të lekut](#)

16:00 Ekonomia / 1 koment

Rruga Kombinat - Plepa: Shpallet fituesi për segmentin 4.9 km, oferta 765.5 mln lekë

15:20 Ekonomia / 2 komente

Shqipëria blen, por shet pak/ Importet rriten në 75.6 miliardë lekë, deficitit tregtar thellohet me 17.4%

20:22 Ekonomia / 1 koment

## Aeroporti i Vlorës, MIE fiton përballjen e parë me Pacollin: Hyn në fuqi zgjidhja e Kontratës së Koncesionit

18:20 Ekonomia / 23 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.